



PROCESVERBAL XI/2023

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 11 (njëmbëdhjetë) për vitin 2023 të Komitetit për Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 13.12.2023
Ora : 13:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues
z. Urim Suka
znj. Bulëza Kuçi
znj. Fidaije Kukaj
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
z. Dardan Berisha
z. Liridon Fandaj

Të pranishëm tjerë:

Habibe Bytyqi - zyrtare për barazi gjinore
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për taksa,tarifa dhe gjobat komunale në Komunën e Suharekës;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës në Suharekë;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit vjetor të punës për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi;**
- 6. Njoftim për kontratat për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës;**

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për taksa,tarifa dhe gjobat komunale në Komunën e Suharekës;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Sanie Kuçi Rexhepaj - këtu konkretisht kanë cekë që Komuna e Suharekës për vitin 2019 nuk e ka dhënë aprovimin që nuk është duke e ndryshu taksën për leje ndërtimore. Por nuk qëndron në atë formë për shkak se Kuvendi Komunal në vitin 2019 ka bërë uljen e taksave për leje ndërtimore dhe leje të rrënimin. Në vitin 2020-2021 është e vërtetë që nuk është bërë një konfirmim sepse ka qenë vit pandemik. Pak më vje inati sepse mbledhjen e tetorit në KPF unë vet i kam dhënë këto rekomandime dhe nuk u ndryshu ndërsa tash ministria ka kërkuar të njëjtat me u largu.

Kryesuesi - është e vërtetë që e ke ngrit si shqetësim por ne e kemi zyrtarin ligjor i cili do të na jep sqarime.

Liridon Fandaj - këto ndryshime është dasht me na dhënë si sqarim që me dit se cili është ndryshmi.

Urim Suka - sikur të ish ky vendim i pari që po na kthehet,në rregull.Por ne gati në secilin takim jemi duke e shqyrtu nga një vendim që po na kthehet. Shqetësimi edhe më i madh është kur temat janë ngrit edhe në KPF dhe s'janë përfill.

Sanie Kuçi Rexhepaj - në vitin 2018 ka hyrë në fuqi udhëzimi administrativ që e ceka edhe unë. Komunitetet kanë pas mundësi me i ndryshu taksat e lejeve të ndërtimit dhe lejeve të rrënimin. Ne si Kuvend e kemi marrë përsipër uljen e taksave dhe është një tabelë kur llogaritet taksa për leje.Mua mu ka dok e paarsyeshme që nëse po bëhet ajo llogari,në fund po i thua palës që edhe 10 € ke me pagu për 2 faqe

letra. Në fund të vitit 2018 ne e kemi inicu si drejtori uljen e taksave. Në vitin 2019 ka hy në fuqi. Në vitin 2020-2021 ne nuk e kemi njoftu ministrinë që ne nuk jemi duke i ndryshu taksat.

Avni Bytyqi - zyrtari ligjor jep sqarime dhe thotë që MAPL e ka kthi për dy çështje: e ka kthi sepse prej 2019-tës faktikisht nuk ka marrë pëlqim për taksën që do me vazhduar me taksën e 2019-tës. Pas konsultimit me ministrinë jemi dakorduar që ne të bëjmë kërkesë për 2024 dhe me apliku prapë taksën 2019 dhe sipas tyre jemi në rregull. Sa i përket propozimit të Sanies, është e vërtetë por në KPF dhe në Asamble nuk ka pas përkrahje. Nëse ministria e ka kthi në rishqyrtim, ne si grup punues kemi ardhë në përfundim që propozimin e Sanies ta inkuadrojmë në rregullore dhe i kemi heq dy taksa: taksën për leje ndërtimore dhe taksën për leje të rrënit. Neni 22 i ligjit për planifikim hapësinor i jep mundësi Komunës kur palët kërkojnë dokumente të planifikimit hapësinor kopje, i jep mundësi që ta caktoj një taks reflektuese nëse don. Në konsultim me Kryetarin dhe si grup punues kemi ardhë në përfundim që ti ngarkojmë qytetarët por mundësia e tyre është që ata mund ti orientojnë përmes faqes së Komunës. Pasi ministria po e kërkon, ne e kemi fut si element. Te ministria e Shëndetësisë është për tu habit për arsye se udhëzimi administrativ që i bën lehtësirat në kujdesin primar është i vitit 2007. Që nga viti 2007 kanë sjell me dhjetëra udhëzime dhe kanë ndryshuar me dhjetëra ligje. I kanë liru njerëzit nga taksat apo nga shërbimet që i ofron kujdesi primar mirëpo ministria e ka kthye dhe ka thënë që ju duhet ti harmonizoni lehtësirat me kujdesin primar sipas udhëzimit administrativ 07/2007 i cili disa lehtësira dhe vendime që i kemi marrë ne, nuk i parasheh. Tjetrën që e kanë kthi ministria e shëndetësisë, është që udhëzimi administrativ i viti 2013 e parasheh çështjen e certifikatave shëndetësore, gjëra të cilat Komuna jonë deri më sot një gjë të tillë nuk e ka pas të inkuadruar në rregullore për arsye se nuk ka qenë kërkesë e asnjë institucioni. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

Liridon Fandaj - nese e kuptova, ne si Kuvend Komunal e kemi pa me i liru disa kategori dhe tash me udhëzimin e vjetër nuk parashihet. Mos është që për këto vendime që i ka marrë Kuvendi Komunal me i konsultu edhe një herë me ministrinë?

Avni Bytyqi - kam bisedu me ministrinë dhe ata kanë thënë që ju me akte të juaja rregulloni si të doni por duhet ti përmbaheni udhëzimit sepse ne e kemi rregull dhe parim për të gjitha Komunat.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

5 për, 2 abstenime

Miratohet pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Dardan Berisha - neni nuk e përcakton. A vlen ajo që ke thënë më herët që mandati i komisionit është vetëm për këtë ?

Avni Bytyqi - jo, nuk ka hy ende në fuqi ligji i ri.

Dardan Berisha - ky komision ka mandat vetëm për këtë pronë.

Avni Bytyqi - po.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

Unanimisht Miratohet

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës në Suharekë;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe thotë që kërkesat që kanë dalë në takim janë inkuadruar. Hap debatin.

Urim Suka - mua më shqetëson pjesa ku unë kërkoja edhe për komisionet. Ju nuk e keni parapa në takimin që e kemi pas dhe unë prap dua ti qëndroj kësaj kërkesë, nëse mujna me inkuadruar që të formohen të paktën 4 apo 5 komisione të Kuvendit të cilat e monitorojnë punën e ekzekutivit. Duke pa zhvillimet e

fundit që po ndodhin me buxhetin dhe mënyrën se si po shpenzohet paraja publike,unë mendoj që është detyrë parësore me pa se çfarë po ndodh me këtë buxhet dhe me dhënë kontributin tonë dhe me parandalu këtë dukuri negative që po ndodh me shpenzimin e parasë publike. N'kuptimin e këtyre komisioneve,ato bëhen prej krejt partive dhe pastaj zani i atyre komisioneve mund të jetë më i fuqishëm për ti parandaluar këto dukuri. Mendoj që plani i punës është mirë të implementohet sipas asaj që po miratohet, n'kuptimin e asaj që nuk e kemi mbajte fare një seancë vitin e kaluar dhe s'kemi pas arsyetim.

Dardan Berisha - për çështjen e formimit të komisioneve,ne kemi kërku edhe legjislaturën e kaluar. Komisionet që kanë qenë prej Asamblesë ku dhamë dorëheqje krejt duke e përfshi edhe veten që ma e mira e rrugës ka qenë me formu një komision dhe me ja zgjidh problemin Sami Elshanit dhe Bashkim Hoxhës.Nëse shkojmë në çdo drejtori me formu komision,më duket që po dalim pak prej konjukturës tonë si Kuvend. Ndoshta n'këtë rast po du me përkrah Urimin po me një komision që kemi marrë pjesë krejt dhe që duhet me kry realisht atë punë që s'po kryhet,ne krejt dhamë dorëheqje.Unë du me përkrah sepse jemi më në ngjarje por tani kur të shkojmë me raportu,anëtarët tonë kanë me gjet vegza.

Urim Suka - e kuptoj Dardanin sepse vërtetë komisionet nuk po funksionojnë siç duhet por ne nuk duhet me paragjyku.Ne po kërkojmë mu formu komisioni dhe duhet mu kanë të shnoh në mendim. Unë po kam dëshirë që ne ta bëjmë,që komisioni që është prej krejt partive me ndihmu procesin sepse jemi tu degradu si Komunë me mënyrën se si po e shpenzojmë paranë publike dhe kjo është shkelje e ligjeve,dhe njerëzit janë duke dhënë llogari për atë.

Dardan Berisha - unë po të përkrahi por nuk vijnë të tjerët.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

5 për, 2 abstenime Miratohet pika 4

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit vjetor të punës për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - gjatë leximit që e kam bë dje,mu m'ka ardhë keq. Unë mendoj që plani i punës nuk duhet të bëhet vetëm prej koordinatorit. Duhet me qenë si rrjedhojë e një pune të këshillit duke analizu nevojat që kanë qytetarët. Ato nevoja me i inkorporu në plan të punës.

Kryesuesi - planin e ka bërë koordinatori në bashkëpunim me anëtarët e këshillit dhe Kryetarin i cili është kryesues i këshillit.

Urim Suka - në tabelën e planit të punës është mirë të specifikohet për secilën pikë se kush është bartësi. Për mua si dokument është keq i përgatitur. Kisha pas dëshirë me pas një dokument më të mirë të përgatitur,me idenë që ai këshill me dhënë kontribut,me dhënë rekomandime të caktune që me u rrit siguria sepse ka shumë dukuri negative që ndodhin te ne.

Avni Bytyqi - ky plan përgatitet prej vitit 2012. Njëri ndër këshillat më funksional dhe që ka dhënë kontribut më së shumti është KKSB i Komunës së Suharekës në nivel të Kosovës. Mandatin e kaluar vetëm 3 iniciativa që i ka marrë ky këshill,ka shku në nivel të RKS-së në Kuvend dhe janë fuqizu ligje si iniciativë që e ka dhënë ky këshill. KKSB është organ këshillëdhënës,nuk është organ vendimmarrës. Këtë plan e kam përgatit në bashkëpunim me kryesuesin e këshillit dhe me anëtarët e KKSB-së.

Urim Suka - Çka ka të bëj me siguri identifikimi i zonave gjelbëruese përreth shkollave?

Avni Bytyqi - aty ku ka mbeturina përreth shkollave,pse mos me dhënë DKA-ja një ide për me bo zonë gjelbëruese.

Dardan Berisha - në muajin tetor s'ka të bëjë DKA asgjë. Te qentë endacak,e ka ngrit edhe Urimi në Asamble ku janë dhënë 12.000€.S'di çka është bo. Kur janë trajtu?

Avni Bytyqi - si nuk ka plan DKA për festat e fundvitit?

Sanie Kuçi Rexhepaj - DKA mandatin e kaluar ka qenë bashkëpunuese me Komunën për dekorimin e festave të qytetit.

Dardan Berisha - është gabim sepse po ia merr nxënësve 2 javë pushimin.

Sanie Kuçi Rexhepaj - jo,ata e kanë bënë punën praktike.

Kryesuesi - punën e këtij këshilli,sigurinë e ka policia. Faktikisht aty dalin me ide dhe japin rekomandimet dhe në fund Kryetari raporton për punën e KKS-së por raporton në mënyrë sipërfaqësore.

Urim Suka - nuk jemi duke e trajtu në mënyrën ma të mirë të mundshme. Ka ardhë një raport ku thuhet se një lokal në K. Suharekës po bën zhurmë natën. Nuk është një por ka shumë lokale që bëjnë zhurmë.

Dardan Berisha - po trajtohet por çka po ndërmerret konkretisht?P.sh. në muajin prill pika 2.

Avni Bytyqi - në kuadër të njesisë së FSK-së është ekipi për dominim. Ne si këshill diskutojmë dhe i qojmë rekomandim DKA-së që ta bëj planin që ata ekspertë me ardhë dhe me mbajte ligjerata nëpër shkolla për rrezikun e minave. Kjo bëhet çdo vit. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime rreth rekomandimeve që kanë dalë nga ky këshill dhe zbatimit të tyre.

Dardan Berisha - këto rekomandimet dhe gabimet që po i gjejmë ne,ndoshta po e forcojnë edhe punën tuaj.I thuani Drejtorit të Arsimit që me dal dy herë në vit dhe të bëhet një kontroll rutinë.Kam informatë prej prindërve që fëmijët e ciklit të lartë,prej kl. 6 deri 8 mbajnë armë të ftohta.Duhet me dal policia dhe ta bëjnë një kontroll rutinë me mundësinë e Drejtorit të shkollës.

Liridon Fandaj - në bazë të numrit të popullsisë të Kosovës,Suhareka e ka vendin e parë për përdorimin e substancave narkotike dhe atë të moshave të reja nëpër shkolla.

Avni Bytyqi - në kuadër të këtij plani ne diskutojmë çdo vit dhe i japim rekomandime policisë që me dal dhe me patrollu më shpesh por nuk është që këshilli,Kryetari,Kryesuesi ose Kuvendi mundet me ndal dukurinë negative.

Urim Suka - politikat për këtë plan të punës nuk janë domosdoshmërisht kritika apriori që s'është duke bërë asgjë këshilli.Këshilli është duke i kry punët e veta.Unë them,ku të fillojmë me përgatit këtë dokument,me u rrit niveli i përgjegjësive më shumë,sidomos te çështja e sigurisë.Nuk duhet ne me prit me na ndodh një fatkeqësi e madhe dhe tani me marrë masa.Ne duhet me marrë veprime në parandalim.

Avni Bytyqi - ky këshill prej 19 anëtarëve,të gjithë arterët kryesor i ka dhe secili arter e ngrit nga një shqetësim që e ka për territorin e K.Suharekës për çështje të sigurisë dhe ai që është kompetent i japim rekomandim. Rekomandimet që kanë dalë vitin e kaluar dhe kanë qenë kompetencë ekskluzivisht e Komunës,i ka zbatu me përpikmëri.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 5.

Unanimisht Miratohet

Pika 6. Njoftim për kontratat për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - a është rrjedhojë e diskutimit të fundit në Asamble që kemi kërku një raport apo në çfarë cilësie ka ardhë?A është raport i Kryetarit apo i drejtorit?

Armend Krasniqi - ky raport është i zyrës së Kryetarit ku unë e kam ndihmu me përpilu një raport më të thellë.Nuk është si rezultat i kërkesës suaj mirëpo është si rezultat i ligjit në fuqi ku Kryetarët duhet të raportojnë çdo 6 muaj.

Urim Suka - ju ligjin e keni pas prej fillimit por s'keni raportu kurrë.A i përfshin të gjitha kontratat ky raport që i ka lidh Komuna për dhënien e pronave dhe këmbimin e pronave sipas ligjit për dhënie në shfrytëzim apo është vetëm një pjesë e saj?

Armend Krasniqi - jo nuk janë.Krejt kontratat e pas luftës nuk janë.

Urim Suka -po mendoj në periudhën tuaj 2018-2023.

Armend Krasniqi - po janë.

Urim Suka - a janë pagu krejt këto qera se si i keni paraqit këtu?A i paguajnë obligimet që kanë ndaj Komunës operatorët ekonomikë?

Armen Krasniqi - të gjitha kontratat të cilat janë të lidhura midis operatorëve ekonomikë dhe Komunës janë të ngarkuar nga drejtoria e pronës dhe Katastrës por se a janë duke i paguar,nuk kam informata sepse nuk është në dikasterin tim.

Urim Suka - këto kontrata,a kanë deviju prej destinimit për çka janë nënshkruar ?

Armend Krasniqi - ne nuk kemi asnjë informacion në lidhje me devijimin.

Urim Suka - te shkëputja e kontratave më bëri përshtypje që krejt janë me një datë. Kur janë dhënë këto kontrata, çmimet ndryshojnë edhe pse janë të të njëjtit destinim dhe sipërfaqja është e njëjtë. Pse po ndodh kjo?

Armend Krasniqi - pagesat nuk bëhen njëjtë për shkak se ofertuesi varet me sa ka apliku.

Avni Bytyqi - te dhënia në shfrytëzim afatshkurtër, çmimi më i lartë e përcakton fituesin.

Urim Suka - te pjesa e parcelës dytësore në Bllacë, në Asamblenë Komunale ne e kemi dhënë një pëlqim për me inicju procedurën dhe nuk e di a e kemi formu komisionin a jo dhe në fund nuk e kemi dhënë vlerësimin final, nuk kemi votu fare. U kry kontrata pa e kry lëndën.

Armend Krasniqi - në thirrjen e ankandit publik që e kemi bë për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale në Bllacë, kemi inicju procedurë për dhënie në shfrytëzim deri në 10 vite për tokën 3 ha. Ne e kemi formuar një komision në Asamble mirëpo në ligj specifikohet që komisioni i propozon Kryetarit dhe kontratën e nënshkruan Kryetari. Nëse është kontratë afatgjatë atëherë sillet në Asamble dhe Asamblea e inicion më tutje.

Urim Suka - propozimi i vendimit final për “Arta tex” Mushtisht ka ardhë në Asamble dhe ka qenë 15 vite fillimisht.

Avni Bytyqi - komisioni vlerësues pas përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës e procedon te Kryetari i Komunës për rastet për periudhën e shfrytëzimit afatshkurtër. Bazuar në rekomandimin e komisionit vlerësues, Kryetari i Komunës e nënshkruan kontratën e përzgjedhur.

Sanie Kuçi Rexhepaj – për rastin në Mushtisht, në KPF kam propozu që me u kthy në afatgjatë dhe në momentin që u kthy në afatgjatë ajo u shpall si konkurrim i hapur.

Liridon Fandaj - pse këtu kur është nënshkrua kontrata, nuk e ka edhe datën se kur përfundon kontrata. Te pjesa e shkëputjes së kontratave, a e keni inicju ju? A e kanë pas këta një garancion bankar për këto investime që e kanë mbajtur një kohë këtë pronë dhe sot e lëshojnë?

Armend Krasniqi - te shkëputja e kontratave, kur të bëhet përfundimi i kontratave zakonisht duhet secilën veç e veç me gjet. Nuk i kam obligua zyrtarët sepse merr kohë një muaj. Kështu që e kemi përgatit brenda ditës vetëm në ato që i kemi dhënë. Komisioni ka qenë i formuar që ti jep rekomandime Kryetarit se çfarë kontrata duhet me shkëput dhe të njëjtën ditë janë shkëput 11 kontrata. A kanë pas apo jo garancione bankare unë them që ne nuk jemi zyre e pronës së garancionit bankar.

Avni Bytyqi - garancioni bankar askënd nuk e eliminon prej garës. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 6.

Unanimisht Miratohet pika 6

Takimi përfundoi: 14:25

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj